

VENDIMI
Nr.591, datë 16.12.1999

**PËR MIRATIMIN E PUBLIKIMIT TË KËRKESËS PËR SHPALLJEN E SHPRONËSIMIT
PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TOKË BUJQËSORE, TË
PRONARËVE NOVRUZ AGALLIU DHE OSMEN KOSOVA, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I URËS NË FSHATIN LUMAS, KOMUNA LUMAS, RRETHI BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994, “Për shpronësimin për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtëshme”, me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për publikimin e shpalljes së shpronësimit për interes publik të pasurive të paluajtshme 400 m2 tokë bujqësore (të kthyer në truall) dhe 350 m2 kulturë r mbjellë, që preken nga ndërtimi i urës në fshatin Lumas, komuna Lumas, rrethi Berat, me investimet e Fondit të Zhvillimit Shqiptar dhe të komunës Lumas.

2. Lista emërore e pronarëve të këtyre pasurive që do të shpronësohen së bashku me sipërfaqet përkatëse të shpronësimit i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ngarkohet këshilli i rrethit Berat dhe komuna Lumas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë në Fletoreb Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PRONA E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHET

Nr.	Emri Mbiemri	Prona që do të shpronësohet tokë bujqësore kthyer në truall në m2	Vlera e kompensimit në lekë
	1.Norvruz Agalliu	250 m2	80 000
	2.Osmen Kosova	150 m2	48 000
Nr.	Emri Mbiemri	Sipërfaqja me kulturë bujqësore e dëmtuar në m2	Vlera e kompensimit të kulturës bujqësore të dëmtuar në lekë
	1.Norvruz Agalliu	250 m2	10 500
	2.Osmen Kosova	100m2	2 000